



## Biblioteka hap dyert e saj për të gjithë lexuesit

*"Libri është diçka e mrekullueshme dhe shumë me vlerë. Ai duhet të mbrohet, lexohet dhe të përdoret nga të gjithë," thotë Ambasadori Paskal Fieski, Shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë.*

Nga: Patrick Hoffman

Për herë të parë që nga shpërthimi i konfliktit, në Lipjan është hapur një bibliotekë multietnike që mirëpret dhe ofron material për të gjitha komunitetet. "Kjo u bë e mundur përmes bashkëpunimit të Qeverisë Holandeze e cila siguroi mjetet financiare përmes 'Fondit për Investime të Vogla për Minoritetet' të administruar nga OSBE-ja. Kuvendi Komunal mori përgjegjësinë për administrimin dhe ndërtimin e kësaj biblioteke. Ky është një shembull i mirë se si bashkëpunimi mund të sjell rezultate," tha Ambasadori Fieski me rastin e përvitmit të bibliotekës.

Fëmijët janë e ardhmja e Kosovës. Me brezin e ri mëtohet të ndërtohet një shoqëri shumëetnike, ku të gjithë do të jetonin në paqe dhe tolerancë. "Kjo bibliotekë është një investim i rëndësishëm," tha Adil

Rashiti, Drejtor i Departamentit për Rini, Kulturë dhe Sport. "Duke u ofruar libra fëmijëve tanë, ne investojmë në ardhmërinë e tyre, por edhe në të ardhmën e Kosovës," tha ai.

Ofrimi i një oaze edukative plot jetë në Shtëpinë e Kulturës për të gjitha komunitetet e Lipjanit, ndihmon në afrimin e fëmijëve dhe inkurajon pajtimin ndëretnik. "Shpresoj se tani do të ketë mjaft fëmijë duke vrapuar së bashku dhe duke kërkuar e lexuar librat me kënaqësi," tha Ambasadori Fieski.

Në të kaluarën, Shtëpia e Kulturës nuk shfrytëzohej nga të gjitha komunitetet. Liria e lëvizjes ishte një prej arsive, gjithashtu edhe frika dhe ndjenja se nuk do të jenë të mirëseardhur. Në të vërtetë, librat në gjuhën serbe kanë qenë të grumbulluara në një dhomë të veçantë në Shtëpinë e Kulturës dhe kanë qenë në dispozicion të lexuesve. Nenad Arsiq, një qytetar nga Lipjani na tha: "mendoj se hapja e bibliotekës është një ide e shkëlqyer, sepse fëmijët e komunitetit serb tani do të kenë mundësi që t'i lexojnë ato libra. Më parë, edhe nëse kanë dashur që të lexojnë, ata nuk kanë mundur që të gjejnë libra. Është një veprim shumë i qëlluar." Qasja në to më nuk është problem.

Një aspekt tjetër që vlen të përmendet është se komuna ka punësuar z. Ivica Djokiq, një bibliotekist serb që të bëjë regjistrin e librave në gjuhën serbe dhe të bashkëpunojë me bibliotekistin shqiptar. "Unë ndihem shumë mirë që punoj me kolegët e mi shqiptarë të Kosovës. Prej se kam filluar të punoj, biblioteka është vizituar nga fëmijë serb dhe shqiptarë. Nuk kam hasur në ndonjë problem dhe puna e ime po më pëlqen shumë." Në inaugurimin e bibliotekës, Ambasadori Fieski shprehu kënaqësinë e tij dhe çmoi faktin se Kuvendi Komunal ka punësuar një serb të Kosovës duke e konsideruar si, "një hap drejt pajtimin në këtë komunë. Tani fëmijët do të kenë dy bibliotekistë në dispozicion që t'i ndihmojnë atyre që



Ambasadori i OSBE-së Paskal Fieschi gjatë inaugurimit të bibliotekës në Lipjan

t'i gjejnë librat," shtoi ai.

Sot, fëmijët e Lipjanit janë së bashku dhe kënaqen me librat në të dy gjuhët. Ata do të kenë në dispozicion edhe një kompjuter si dhe tavolina leximi dhe karriga, të cilat e bëjnë bibliotekën vend të përshtatshëm për mësim. Biblioteka tani e tutje do të ketë edhe libra me poezi, letërsi, histori dhe shkencë për të rritur, që arrijnë shifrën prej mëse 19,000 librash.

Qëllimi i 'FIVM'-së ishte që të sigurojë një numër të njëjtë librash, andaj edhe ky kontigjent librash i cili i është dhuruar bibliotekës përmbar rreth 1300 libra në gjuhën serbe dhe rreth 1600 në gjuhën shqipe. Z. Ahmet Karameta, bibliotekisti shqiptar në Shtëpinë e Kulturës së Lipjanit tha, "shumë qytetar po i dhurojnë vullnetarisht libra bibliotekës, kështu që ajo po rritet dita-ditës."

"Ky është një hap i rëndësishëm për të gjitha komunitetet. Deri më tani ne nuk kemi pasur as bibliotekë shumëetnike e as bibliotekë për fëmijë, kurse tani i kemi që të dyja. Duke iu falënderuar ndihmës dhe

mbështetjes së OSBE-së, tash e tutje lexuesit e niveleve të ndryshme, përfshirë këtu fëmijët, mund të vijnë dhe të kënaqen duke lexuar në bibliotekën e tyre," that z. Karameta.

Që nga inaugurimi zyrtar i bibliotekës nga ana e Ambasadorit

të OSBE-së Fieski, dyert e saj kanë qenë të hapura për çdo fëmijë, burrë e grua, pa marrë parasysh se kush janë ata. Bashkëpunimi ndëretnik me të vërtetë ka sjellur rezultate nga të cilat do të përfitojnë të gjitha komunitetet.

Libra për të gjithë



### NË KËTË NUMËR

Një kredi e vogël por efekti i madh

faqe 3

Shpresat e pathyera

faqe 4

Oaza e paqës dhe pikurat e fëmijëve

faqe 6

Përmirësimi e standardit jetësor dhe infrastrukturës

faqe 7

## EDITORIALI



### Ambasadori Pascal Fieschi, Udhëheqës i Misionit

Në shoqëritë e mbarë botës, bashkësitë etnike shpesh konsiderojnë se nuk u kushtohet vëmendja e duhur. Konflikti mëton ta rëndojë këtë gjendje, ashtu siç ishte rasti në Kosovë.

Që nga konflikti dhe shpëputja e marrdhënieve, pajtimi i bashkësive kosovare, pa marrë parasysh se kush janë, ka qenë një nga lëmitë tona kryesore të punës. Tri vite e gjysmë më vonë, përpjekjet për pajtim (të llojit nga lartë-poshtë) nga ana e figurave eminente këtu në Kosovë - pa marrë parasysh faktin se sa intelgjent e të ndieshëm, ose sa të sofistikuar janë teknikat e tyre - akoma nuk po i sjellin rezultatet e pritura. Një deklaratë ose veprim ekstrem mund të rrenojë iniciativën më të suksesshme post-konfliktuale për pajtim.

Nuk ka dyshim se qëllimet kërkojnë kohë për tu përbushur, pa marrë parasysh kush i bën këto përpjekje. Ndoshta duke futur teknikë nga poshtë-lartë, ku njerëzit takohen në nivelin lokal për të filluar procesin e pajtimit, mund të jetë një strategji më e dobishme, veçanërisht nëse përdoret në bashkëpunim me përpjekjet nga lartë-poshtë. Unë besoj se mund të arrihet shumë nëse fokusohemi në arrijtjen e progresit solid në lëminë e bashkjetesës, pajtimit dhe bashkëpunimit në nivelin lokal.

Sigurimi i një të ardhmeje të drejtë dhe prosperuese për të gjitha bashkësitë është qëllim qëndror i Misionit të OSBE-së në Kosovë. Si pjesë e këtij qëllimi, dhe në mënyrë që të përkrahet natyra pajtuese e qasjes në nivelin lokal, ne kemi themeluar 'Fondin për Investime të Vogla për Minoritetet' (FIVM) për të inkurajuar kthimin, mbështetur integrimin e bashkësive në shoqëri dhe për të promovuar pajtimin.

Qeveria e Holandës ka dhënë 1.2 milion Euro për 'FIVM'. Kjo mbështetje na ka mundësuar të implementojmë 47 projekte të dobishme në tërë Kosovën. Buxheti më i lartë prej 50,000 eurosh ishte ndarë për një projekt dhe secili prej tyre ka qenë i suksesshëm në dhënie të rezultateve të shpejta dhe të mirëfillta në bashkësi.

Projektet e 'FIVM' ndryshojnë për kah fusha e veprimit, duke u përqëndruar në të gjitha lëmitë si arsimi, nevojat shoqërore dhe mediat e deri te infrastruktura dhe kreditë. Kam qenë dëshmitar i hapjes së bibliotekave dhe ambulancave të 'FIVM' botimin e revistave, inaugurimit të ujësjellësve, sistemeve të ngrohjes, aktiviteteve sportive e kulturore, ofrimin e trajnimeve në gjuhë të huaja dhe kompjuter në shumë bashkësi etnike në Kosovë.


Një komponentë e rëndësishme e projekteve të 'FIVM'-së ishte fakti se bashkësitë ishin të përfshira në mënyrë aktive që nga fillimi në implementimin dhe realizimin e tyre. Kjo përfshirje u bë në formën e ofrimit të kredive ose shërbimeve dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm, duke marrë në të njëjtën kohë përgjegjësinë lokale.

Me sa duket, dallime ka edhe sot por ato duhet të bëhen më pak domethënëse. Ideja e një shoqërie gjithëpërfshirëse, të bazuar në parime demokratike do të zhvillohet dita më ditë, gjatë kohës që bashkësitë do të përafrohen në punët e tyre të përditshme. Shpresoj se bashkësitë etnike do të mbesin një pjesë përbërëse e shoqërisë së Kosovës përbrenda kontekstit të kufirit Evropian.

Unë ende besoj se pajtimi është praktik dhe i mundshëm, dhe kam dëshirë të shoh vazhdimin e tij. Integrimi i plotë - veçanërisht në një shoqëri si Kosova - mund të mos ketë gjasa në një të ardhme të afërt, por hapat e duhur janë duke u bërë.

Është jetike për organizatat si OSBE-ja, e cila punon për të promovuar një shoqëri të shëndoshë, të përqëndrohen në aktivitetet e tyre në të gjitha nivelet: në atë institucional, qeveritar dhe lokal. Besoj fuqishëm se pajtimi do të jetë i mundshëm nëse i qasemi në këtë mënyrë.

Projektet e 'FIVM' kanë treguar me sukses se sa mund të arrihet në nivelin lokal duke përfshirë bashkësitë dhe duke bërë investime të vogla. Këto projekte kanë përkrahur kontaktet në mes të njerëzve të rëndomtë në nivelin lokal. Aro pashtu ndikojnë në nivelin qeveritar dhe institucional për të synuar një vizion konsensual për Kosovën.



#### Citate

Duke iu drejtuar pjesëmarrësve të kampionatit të basketbollit në Shtërpçë, zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) theksoi rëndësinë e sportit dhe bashkëpunimit në krijimin e Kosovës tolerante dhe shumëtrike. Kampionatit të Brezovicë që u realizuar nga FIVM-ja është një shembull i mirë i gjenerimit të iniciativave për projekte të ngjashme në të ardhmën, duke përfshirë këtu edhe kampionatit sportiv 3 javor në Shtërpçë ku morën pjesë mëse 150 të rinj nga të gjitha komunitetet e Kosovës.

*Nga Katherine Green*

Përmes implementimit të projekteve shumëtrike të FIVM-s, një numër aktivitete interesante u realizuan në tërë Kosovën. Ishin disa projekte kulturore që u realizuan nga pjesëmarrës të komuniteteve të ndryshme. Një projekt i tillë ishte hapja e bibliotekës për fëmijë në shtëpinë e kulturës në Lipjan. Për herë të parë që nga pëfundimi i konfliktit anëtarët e të gjitha komuniteteve shkojnë në të njëjtën bibliotekë. Kjo mund të vlerësohet si një hap pozitiv dhe i rëndësishëm drejt normalizimit të marrëdhënjëve në mes të komuniteteve.

*Nga Margarethe Matic*

## DEAE DEALS DEALI

Rruga Beogradit 32 38000 Pristina  
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188  
E-mail: [press@omik.org](mailto:press@omik.org)

Botuesi:  
Sven Lindholm  
Kryeredaktore:  
Charlotte Granville-Ross  
Redaktore:  
Hasan Sopa (Detaje)  
Slavisa Mladenovic (Detalji)  
Dizenji & Faqesja  
Shpend Kada

Bashkëpunetoret:  
Srojan Antic, Edita Bucaj,  
Chris Cymmanick, Arjan Haxhibeqiri,  
Xhemë Ibraj, Rexhep Krasniqi,  
Fatime Lepaja, Nderim Pasuli,  
Ivana Petrovic, Gëzim Rexha,  
Halide Sadiku, Meryde Salihu,  
Mustafa Skenderi, Slavica Staletovic,  
Armed Tahirsylaj, Irfan Ukshini,  
Bernard Vrbani

**OSCE**  
Mission in Kosovo

Shënim:  
Pikëpamjet e paraqitura apo prezantimi i materialeve të botuara nuk shprehin politiken, opinionet apo qëndrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë.

# Ndihmohen komunitetet në Kosovë

*"Fondi për Investime të Vogla për Minoritete" (FIVM) është krijuar me qëllim që Misioni i OSBE-së të shtoi kontributin e vetë në fushat e qëndrimit, kthimit dhe pajtimit në nivelin më të ulët në tërë Kosovën." - thotë z. Göran Stigmer, kryesues i Bordit Konsultativ të 'FIVM'-së.*

Intervista dhe Photo: Hasan Sopa

**Detajet:** Cka është "Fondi për Investime të Vogla për Minoritete" (FIVM)?

**Z. Stigmer:** Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMiK), ka themeluar 'Fondin për Investime të Vogla për Minoritete' në vitin 2001. Qëllimi i këtij fondi ka qenë të inkurajojë kthimin dhe të promovojë pajtimin. Synim tjetër kryesor ka qenë inkurajimi i komuniteteve etnike të qëndrojnë në Kosovë duke iu përmirësuar kushtet për jetesë. Projekti është përkrahur nga qeveria Holandeze, e cila ka dhënë përafërsisht 1.2 milion € gjatë një periudhe dyvjeçare.

**Detajet:** Cili ka qenë fokusi kryesor i projekteve?

**Z. Stigmer:** Kemi kërkuar nga të gjitha zyret e OSBE-së në Kosovë të paraqesin projekt-propozime të cilat do të përmirësonin kushtet e jetesës së grupeve etnike, në veçanti grupeve më të ndijeshme. Kemi menduar se kjo është e domosdoshme për të krijuar besim dhe për të siguruar siguri në kuptim më të gjerë, duke shtuar pjesëmarrjen e komuniteteve etnike në procesin demokratik. Një mënyrë për ta bërë këtë kanë qenë projektet përkrahëse të shpejta dhe me ndikim të madh. Gjatë këtyre dy viteve, zyrtarët tanë në terren, së bashku me kolegët e tyre vendorë, kanë implementuar 45 projekte. E di se këto projekte janë çmuar shumë nga popullata vendase.

Do të doja gjithashtu t'i falenderoj kolegët e mi në terren si dhe ata në zyra qendrore të cilët kanë qenë të përfshirë në menaxhimin e këtyre projekteve. E di se këto projekte kanë kërkuar shumë punë dhe orar të zgjatur. Por jam i sigurt se e tërë kjo punë na është shpërblyer të gjithëve.

**Detajet:** Cilat kanë qenë kriteret për këto projekte dhe si ka shkuar i gjithë procesi?

**Z. Stigmer:** Një Bord Konsultativ me përfaqësues të organizatave të ndryshme që punojnë në fushat e qëndrimit, kthimit dhe pajtimit është themeluar me qëllim të vlerësimit të projekt-propozimeve nga të gjitha këndvështrimet. Bordi ka vlerësuar projektet dhe ka përcaktuar nëse i kanë përmbushur kriteret. Më duhet të them që fusha ka qenë shumë e gjërë. Projekt propozimi më kanë përfshirë fusha si infrastruktura, arsimit, përkrahja sociale si dhe komunikimi, informimi dhe mediat. Bordi Konsultativ ka vlerësuar të gjitha projekt-propozimet me kujdes. Shumë nga propozimet e dorëzuara janë përpunuar me kriteret e caktuara kështu që janë miratuar. Ka qenë punë e vështirë, por është shpërguar.

**Detajet:** Çfarë ndikimi kanë pasur projektet? A mund të na jipni ndonjë shembull?

**Z. Stigmer:** Së pari, më duhet të them se të gjitha projektet kanë pasur ndikim shumë të madh



*Z. Göran Stigmer ka punuar për OMIK-un që nga viti 1999 kur ka filluar në Mitrovicë si Koordinator Rajonal. Në vitin 2001, ai ka punuar si Drejtor i Zyres Rajonale të OSBE-së në Prizren dhe nga janari i vitit 2002 si Drejtor i Zyrave të OSBE-së në teren. Përvoja e tij në Ballkan ka filluar në vitin 1992 kur ka punuar për Misionin Monitorues të Komitetit Evropian (ECMM), tani Misionin Monitorues i Unionit Evropian (EUMM) në Kroaci, pastaj funksionet e tij në Kroaci dhe Bosne dhe Hercegovinë për OSBE-në, UN-in, Federatën Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Shoqatës së Gjysëm-hënës së Kuqe.*

në komunitetet ku janë implementuar. Një projekt që mund të përmendet është implementuar në fshatin Livoç të komunës së Gilanit, i banuar me shqiptarë dhe serb. Ky fshat ka pasur nevojë shumë të madhe për një ambulancë (shtëpi shëndeti) e

cila do t'iu shërbente popullatës në fshat si dhe fshatrave përreth, por nuk kishte të holla në dispozicion. Pas shumë pune përgaditore nga ana e stafit tonë dhe autoriteteve lokale në Gjilan, projekt propozimi ishte përgaditur dhe dorëzuar Bordit Konsultativ, dhe ishte miratuar.

Unë isha Livoç me rastin e inaugurimit të amulancës dhe më duhet të them se kam qenë i befapsuar për të mirë. Që nga fillimi kanë qenë të përfshirë në projekt të dy palët, shqiptarët dhe serbët. Për më tepër, stafi mjekësor është punësuar nga të dy grupet etnike. Kjo ka qenë me rëndësi sepse ambulanta synon t'i shërbejë popullatës shqiptare dhe asaj serbe. Përdërisa fillimisht komuna ka marrë pjesë në implementimin e projektit me 10% të shpenzimeve, më vonë, ata kanë marrë një rol më aktiv duke mbuluar shpenzimet rrjedhëse kryesore në lidhje me ambulancën. Për këtë arsye, unë jam i bindur se ky projekt është i qëndrueshëm dhe do të vazhdojë t'i shërbejë popullatës në Livoç.

Një projekt tjetër interesant është implementuar në sektorin financiar. Siç e dimë të gjithë, situata ekonomike në Kosovë nuk është e mirë dhe nevoja për mikro-kredi ka qenë, dhe vazhdon të jetë, shumë e madhe. Kjo vlen për tërë vendin, por në veçanti për rajonet e banuara nga komunitet etnike. Prandaj, përfaqësuesit e Qeverisë Holandeze kanë mirat-

uar një propozim për fond të veçantë për kredi në shumë prej 255.646€ që të adresohet ky problem. Tri OJQ (lokale dhe ndërkombëtare) që punojnë në sektorin mikro-financiar janë zgjedhur për implementimin e projektit i cili ka pasur ndikim pozitiv për shumë njerëz në Kosovë.

Do të mund të vazhdojë të flisja për projekte të ngjashme. Por mendoj se kjo që thash deri më tani u jep një ide se çfarë ndikimi kanë pasur projektet e "FIVM" në Kosovë. Unë shpresoj që Misioni i OSBE-së në Kosovë, do të jetë në gjendje të vazhdojë me aktivitete të ngjashme edhe në vitin 2004.

**Detajet:** Cila do të ishte porosia juaj për donatorët e ardhshëm potencial?

**Z. Stigmer:** Porosia ime për donatorët e ardhshëm potencial do të ishte t'i ndihmojnë OMIK-un në përkrahjen e komuniteteve etnike që të qëndrojnë në Kosovë duke iu përmirësuar kushtet e jetesës. Fondet gjithashtu do të mund të promovonin pajtimin dhe përkrahjen e të drejtës për kthim. Kjo do të mund të arrihej duke financuar projekte të vogla ose të mesme, të cilat adresojnë nevojat vitale në komunitet. Natyrisht, të gjitha projektet do të zhvilloheshin në bashkëpunim me komunitetet etnike lokale dhe organizatat që punojnë në fushat e qëndrimit, kthimit dhe pajtimit.

## Një kredi e vogël por efekti i madh

*"Një kredi do të thotë shpresë, do të thotë e ardhme, do të thotë fëmijë të arsimuar dhe jetë më të mirë për hua-marrësit dhe punëtorët e tyre," shpjegon z. Yurie Shulhan, drejtor i Fondacioni të Komunitetit Ndërkombëtar për Asistencë (FINCA) në Kosovë.*

Nga: Charlotte Granville-Ross



*z. Musa Caca i zënë në puntorin e tij prej farkatari*

Kërkesa për mikro-kredi është shumë e madhe në mbarë Kosovën. Mirëpo, nevoja është më e madhe dhe e paplotësueshme në mes të komuniteteve etnike në Kosovë. Lëvizja e lirë mbetet problem për shumë nga këto komunitete, duke i penguar ata që të kërkojnë kredi nëse kreditë nuk arrijnë te ata.

FIVM-ja përmes një tenderit ka

zgjedhur tri institucione mikro-financiare, që mbulojnë shumicën e Kosovës gjeografikisht, për të bërë implementimin e projektit mikro-kreditor në vlerë prej 255,646 Eurosh në komunitetet etnike. Këto institucione mikro-financiare janë 'Besëlidhja/Zavet', 'FINCA Kosova' dhe 'ADIE International'.

Duke u përqëndruar në infra-

strukturën ekonomike, e cila përfshinë rehabilitimin ose zhvillimin e ndërmarryeve ekonomike përmes projektit për mikro-kredi të FIVM-it, institucionet kanë synuar shtimin e pjesëmarrjes së komuniteteve etnike në procesin demokratik, duke siguruar masa për ndërtimin e besimit dhe sigurisë.

"Ky projekt është një shembull i shkëlqyer se sa shumë mund të arrihet me diçka të vogël kur t'i jenë përshtatur me kujdes nevojave të komunitetit", thotë z. Shulhan nga FINCA. Të tri institucionet mikro-financiare kanë punuar më së shumti në fushat e tyre të veprimit. FINCA ofron 24 kredi prej gjithësejt 102,258 € në shërbim, tregti dhe në lëminë e prodhimit, 'Besëlidhja/Zavet' i ka paguar 146,000 € deri 88 përfitues nga komunitetet të ndryshëm etnike në lëminë e bujqësisë, tregtisë dhe shërbimeve, dhe ADIE, 45 kredi gjithësejt €51,129 në bujqësi.

Z. Musa Caca është njëri nga klientët romë të FINCA-së. Kredia prej 10,000 € i ka mundësuar atij të zgjerojë dhe zhvillojë biznesin e tij të njohur si farkatar me traditë familjare prej tri gjeneratash në Prizren. Z. Caca na tregoi, "unë jamë shumë i kënaqur që kam marrë kredi. Kjo më mundëson që të shtojë kapacitetin e biznesit". Z. Caca ka ndër mend të marrë prapë kredi pasi ta kthejë këtë, ndoshta kur të rritet djali, i cili do të bëhet gjenerata e katërt e familjes që merret me këtë biznes.

Fillimisht, duke iu ofruar komuniteteve etnike me shumë resurse për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike shpeshherë ndihmohet krijimi i vendeve të punës si dhe siguri dhe besim, por në fund të fundit, i tërë komuniteti mund të përfitojë aq sa biznesi të zgjerohet për një afat të gjatë.

Z. Milorad Filipoviq, një fermer që merret me kultivimin e derave dhe jeton në Graçanicë, ka

marrë një kredi prej 1000 € nga Besëlidhja/Zavet. Z. Qoi, drejtor i kësaj organizate thotë, "kjo kredi i ka mundësuar Z. Filipoviq të zgjerojë fermën e tij prej 9 në 19 derra dhe 40 gica, dhe tani e shfrytëzon tokën më shumë dhe siguron punën për djemtë e tij." "Në të ardhmen, kur Z. Filipoviq do të ketë 40 derra të rritur, do të jetë në gjendje të shfrytëzojë të katër hektarët e tokës së vet dhe ndoshta do të punësojë edhe punëtorë tjerë," shtoi ai. Z. Shulhan gjithashtu tregoi "pas fillimit të suksesshëm, është shumë e rëndësishme të vazhdohet projekti i mikro-kredive të 'SIMF'-it, në mënyrë që të ketë ndikim më të madh, dhe të arrihen përmirësime të qëndrueshme për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Në të vertetë, pasiqë ky është një financim me kredi, me kthim parash, të njëjtat para mund të japin shpresë të mëtejshme për familjet dhe bizneset e reja, në mënyrë që të përfitojë i tërë komuniteti".

# Shpresat e pathyera

Në shkurt të vitit 2003, 30 të rinj serb dhe shqiptarë të Kosovës nga komuna e Shtërpçës dhe Prizrenit morën pjesë në një kamp shumë-etnik basketbolli, të organizuar nga 'Fondi për Investime të Vogla për Minoritetet' (FIVM). Bashkëpunimi dhe besimi ishin ndërtuar, shkathtësitë ishin përmirësuar dhe të gjithë ishin zbatimur. Në të vërtetë, suksesi i projektit ka qenë i atillë që më vonë ka pasuar me seminare dhe kampe tjera shumë-etnike siç është udhëtimi i fundit për në Poloni.

Nga: Michael Kirby



Një anëtar i ekipit fitues duke festuar

Në rrugë e sipër për në qytetin e Koziences në Poloni, u takova me Dragosllav Janiqeviqin, Milosh Nikolqeviqin dhe Trifun Peqinoqeviqin, anëtarë të Klubit Basketbollistik të Shtërpçës. Këta djemë serb të Kosovës, të gjatë e të hollë, ishin të mbushur me entuziazmin tipik për moshën e tyre adoleshente.

Edhe pse të tre djelmoshat i njihja nga lojrat miqësore në sallën e shkollës së mesme 'Jovan Cvijiq', ose nga ndonjë

stërvitje e rastit në Hotelin Narcis, asnjëherë nuk kisha patur rast të ulem me ta dhe të njoftohemi më mirë. Bisedat e mëhershme përbëheshin kryesisht nga "daj mi lloptu", ose pasthirrat kur humbej ndojnë shënim i lehtë. Pasi u interesova fillimisht rreth projektit të kampit basketbollistik të financuar nga 'FIVM' në Brezovicë shkurtin e kaluar, Dragosllavi, më i moshuari i grupit, rrotulloi sytë dhe me një shikim të ndrojtur më tha,

"ishte mirë të luaje me shokët shqiptar të ekipit."

"Mjaft të lutem," ndërhyra me sërbshten time të dobët, "nuk kam ardhë këtu dje." Buzëqeshjet dhe qeshja e lehtë sinjalizuan se ata nuk ishin të singertë. Edhe pse kanë kaluar katër vite pas intervenimit të NATO-s, afrimi i të rinjve shqiptarë dhe serb në Kosovë mbetet një përpjekje e vështirë. Sidoqoftë, duke kontribuar në interesat e përbashkëta në sport, siç është basketbolli, fillimi i procesit të pajtimit është i mundur.

"Si keni komunikuar?" pyeta.

"Shumë njerëz e flasin gjuhën serbe, dhe kur luani basketboll, thjeshtë komunikoni pa fjalë. Kur luaj basketboll, unë nuk mendoj me kënd po luaj, por si të shënoj," u përgjigj Dragosllavi.

Komuna e Shtërpçës është vend i veçantë ku njerëzit nga e tërë Kosova bashkohen për t'u kënaqur në një atmosferë miqësore. Në të vërtetë, komuniteti shqiptarë dhe ai serb punojnë së bashku brenda një strukture komunale këtu. Kështu që nuk ka qenë befasi që adoleshentët e komuniteteve të ndryshme të bashkohen për kampin basketbollistik shumë-etnik të 'FIVM' në Shtërpçecë.

Miloshi dhe Trifuni flisnin lirshëm për pjesët më intere-

sante të kampit si gara për shënim për tri pikë dhe turniri i ekipeve të përziera. 17 dhe 18 vjeçarët respektivisht, Miloshi dhe Trifuni kanë idol yjet e NBA-së Majkëll Xhordanin dhe Allën Ajversonin. Edhe pse garojnë vetëm që dy vite, të dy djelmoshat mendojnë të luajnë basketboll në të ardhmen, mundësisht në kolegji.

"Kampi për basketboll i 'FIVM' në Brezovicë ka hapur dyertë për shumë djelmosha," tha

lojtari/trajneri Sasha Davidoviq. "Lojtarët kanë ndërtuar marrëdhënie pozitive dhe suksesi i kampit ka lejuar klubin basketbollistik të Shtërpçës, së bashku me Ministrinë e Sportit, të organizojë aktivitetet tjera si kampi dy-javorë në Poloni. Mendoj se kjo ka qenë arritje e madhe, dhe mendoj se të gjithë në Kosovë, posaçërisht liderët dhe politikanët, do të mund të mësonin shumë nga këta djelmosha.



Bisedat ekipore jashtë vijes anësore

## Gjëra të vogla, ndryshime të mëdha

Në shumë pjesë të botës autobusët janë mjete të rëndomta transporti - të lirë dhe të thjeshtë. Në Kosovë, autobusët paraqesin diçka më shumë. Sidomos kur janë falas.

Nga: Edita Buçaj

Dragashi është një komunë e largët në jug të Kosovës, ku shumica e banorëve i përkasin bashkësisë gorane. Duke qenë rajon malor, Dragashi është i njohur për dimra të hershëm dhe të egër. Shtu këtu motin e lig, kushtet e vështira jetësore dhe papunësinë e madhe, prindërit e kanë më të lehtë të arsyetohen për të mos dërguar fëmijët në shkollë, veçanërisht kur është fjala për vajzat.

Fatmirësisht, për këtë është gjetur zgjidhja. 'Fondi për Investime të Vogla për Minoritetet' ka bërë një projekt për t'u ofruar transport fëmijëve dhe të rriturve goranë. Në këtë më-

nyrë dukshëm është përmirësuar ndjekja e orëve të mësimi si dhe qasja në punësim e të rriturve. Ky projekt i vogël ka bërë ndryshime të mëdha.

Një projekt i ngjashëm është implementuar edhe në veri të vendit, në Zveçan. Tridhjetë fëmijë romë të zhvendosur nga Mitrovica jugore, dhe duke jetuar në kushte të vështira në strehimoret e përkohshme, janë duke u transportuar falas për në shkollë. Pa transport, ata vështirë se do të kishin mundur ta ndjekin shkollimin, dhe kjo do të përbente veshtiresë në riintegrimin e tyre. Padyshim, shërbimi i këtillë i ofruar ka qenë

i mirëseadur. "Asnjëherë më parë nuk kam shkuar në shkollë me autobus," thotë Hamiti, nxënës i vitit të dytë. "Kur isha i vogël, shikoja në filma se si nxënësit shkonin e vinin në shkollë tok me autobusin e shkollës. S'kam menduar që edhe ne një ditë do të kemi një shërbim të këtillë... Është një ndjenjë shumë e mirë kur dikush kujdeset për ty," shtoi ai.

Rahoveci është një qytet i Kosovës qendrore, me numër të konsiderueshëm të bashkësisë serbe që jeton në enklava. Gjatë konfliktit Rahoveci ka qenë dëshmitar i luftimeve të mëdha

dhe i humbjes së shumë jetrave. Që nga ajo kohë, bashkësitë etnike kanë zgjedhur që të jetojnë të ndarë, duke iu friguar integritetit. Sidoqoftë, dalëngadalë ata janë duke filluar ta lënë të kaluarën mbropa dhe të integrohen në shoqërinë kosovare. Një projekt i ngjashëm transporti është mirëpritur edhe në komunën e Rahovecit, duke u ofruar qasje banorëve të enklavave në qendër të qytetit.

Ky shërbim komunal i transportit në Rahovec u ka mundësuar nëpunësve civil që të shkojnë në punë falas. Më parë ata është dashur që të shpenzojnë gati tërë pagën vetëm

për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit. Tash ata mund të shfrytëzojnë pagën edhe për nevoja familjare. Përveç kësaj, autobusi u shërben edhe anëtarëve të banorëve që jetojnë në enklava. Ata mund të shkojnë me autobus në qytet dhe të kenë qasje në shërbimet publike dhe komunale. Kjo ka ndihmuar në ndërtimin e besimit dhe integritetit në mes të grupeve etnike.

Siç u tha më lart, autobusët kanë rol të vogël në pjesët tjera të botës, por në Kosovë autobusët janë dëshmi se gjërat e vogla mund të kenë ndikim të madh në jetërat e njerëzve.

**Një reflektim i projekteve të FIVM-s**



*Projektet e FIVM-s kanë dëshmuar se si njerëzit nga të gjitha bashkësit në Kosovë mund të bashkëpunojnë për të mirën e përbashkët.  
Nga Laura Via*

*Unë i dëshiroj Kosovës paqe dhe liri dhe të gjithë njerëzit të jetojnë në harmoni.  
Nga Milena Pesiq*



*Kosova ka vend për të gjithë ne, për serb, shqiptarë dhe për të gjitha nacionalitetet tjera.  
Nga Dushica Milenković*



*Të gjitha projektet kanë pasur një ndikim të konsiderueshëm në cilësinë e jetës të të gjitha bashkësive etnike  
Nga Brian Jupp*

*Shpresoj se përpjekjet e këtyre gazetarëve të rinj nuk do të ndihmojnë vetëm ata të ndihen të kenaqur dhe kreativë, por gjithashtu të ndikojnë në inspirimin e femijëve tjerë që të kontribuojnë në shoqëri.  
Nga Nota Sarafoudi*

*Unë mendoj se suksesi kryesor i projekteve të FIVM-s ka qenë në ngritjen e kuartarit ekzekutiv të kuveneve komunale  
Nga Katherine Green*



*Do të ishte mirë ta hedhim anash të kaluarën dhe t'i kthehemi së ardhmes.  
Nga Ivana Shugiq*



# Oaza e paqës dhe pikturat e fëmijëve

Nga: Ivana Petrović

Fshati Uglar është pjesë e enklavës së vogël serbe në komunën e Fushë Kosovës. Uglari duket si të gjitha fshatrat e Kosovës qëndrore, por ka një specifikë - një shkollë të jashtëzakonshme të pikturimit. 'Fondi për Investime të Vogla për Minoritetet' (FIVM), ka mbështetur këtë shkollë që nga qershori i vitit 2001. Projekti është implementuar përmes departamentit të demokratizimit të OSBE-së ndërsa është drejtuar nga piktori i talentuar nga fshati Uglar, z. Zoran Zhivković.

Duke kaluar portën e madhe për të hyrë në oborr të shtëpisë së familjes së z. Zoran Zhivkovićit, takohesh me një ndjenjë dashamirësie dhe bashkëjetese. Zorani dhe bashkëshortja e tij Verica na mirëpresin. Nën hijen e një druri të arës, me degët e formuara në mënyrë artistike, pjmë kafe turke dhe bisedojmë për historinë e shkollës së pikturimit.

"Shkolla është themeluar kur situata ka qenë shumë e keqe për serbët e Kosovës dhe komunitetin rom që jeton në Uglar, thotë Zorani. "Ata ishin tërësisht të shkëputur nga jeta kulturore në Kosovë pasi që nuk kishin liri të lëvizjes. Mungesa e shprehës shihet veçanërisht të rinjtë, të cilët nuk kishin ndojnë mundësi argëtimi. E pyesja veten si do të mund të përmirësoja jetën e tyre, t'i mbroja nga ambienti i tendosur, dhe kryesisht nga emocione negative me të cilat ata jetonin. Unë gjithashtu doja t'i inkurajoja prindërit që të qëndrojnë këtu,

në vend që të nisen për të bërë jetë të pasigurt diku tjetër si persona të zhvendosur, dhe të tjerët që nuk ishin këtu të kthehen. Arti është treguar si mjet i përsosur në realizimin e qëllimeve të mia", shton Zorani. Ai vazhdon me mburje "ju do të shihni sa i suksesshëm është projekti i shkollës së pikturimit. Asgjë nuk ju tregon më shumë se vet pikturat. Ne këtu kemi kryevepra të vërteta."

Në mes të një koleksioni të pikturave të bukura, aq të bukura sa nuk ngopesh së shikuari, ne e pyesim Zoranin si ka filluar shkolla e pikturimit. "Ne kemi filluar me një projekt pilot tre mujor në qershor të vitit 2000. Grupi përbëhej prej 35 të rinjve nga 10 deri 16 vjeç. Në qershor të vitit 2001, OSBE-ja dhe 'FIVM-i' filluan ta ndihmojnë shkollën,



Zoran Zhivković, arsimtar i artit figurativ

duke e shëndrruar atë në shkollë të përhershme. Që nga ajo kohë artistët të rinj kanë pikturuar 537 piktura të dalluara. Dy nga nxënësit emi tashmë kanë filluar studimet në Akademinë e Arteve në Beograd, dhe njëri ndjek shkollën për artizanat në Nish. Krejt kjo vërteton se puna jonë nuk ishte humbje kohe, por e kundërta."

Ne ishim të interesuar të dijmë më shumë për atmosferën gjatë një ore mësimi. Zorani shpjegon, "unë jam plotësisht i vetëdijshëm se punoj me fëmijë të cilët jetojnë në një situatë jo të zakonshme, ende vuajnë nga sindromet e pasluftës dhe traumat, liria e lëvizjes së të cilëve ende është e kufizuar. Unë mendohem t'i mësojë ata t'i përdorin të gjitha teknikat e pikturimit, vizatimit dhe ngjyrave dhe ta shprehin vetëveten pa ndonjë frikë dhe ngurim. Gjithashtu, bëj përpjekje të përfshijë elemente të argëtimit dhe lehtësimi, në kohën kur ata edhe luajnë. Siç po e shihni oborri im është një vend ideal për këtë. Me të vërtetë fëmijët kënaqen duke punuar dhe mësuar, dhe unë, si mësues i tyre kam arsye të mirë të mburrem me ta".

Ne e pyetëm Znj. Galina Rizova, zyrtare për demokratizim, se si misioni i OSBE-së u interesua për një projekt që i dedikohet artit. "Vetëm shikoni këtë oborr, këtë oazë të qetësisë, bukurisë dhe artit dhe do ta kuptoni. Unë për herë të parë e takova z. Zhivkovićin kur ekspozoi punimet në hapjen zyrtare të 'Qendrës Burimore të OJQ-ve' në



z. Zhivković dhe studentët

Fushë Kosovë me kolegun e tij shqiptar, gjithashtu piktor. Më vonë Zorani ishte zgjedhur partner vendor dhe mësues për këtë shkollë të pikturimit në Uglar." Zonja Rizova shpjegon rëndësinë e këtij projekti për komunitetin vendor. "Kur ne filluam projektin, nuk ka pasur besim të fortë në mes të komunitetit serb dhe organizatave ndërkombëtare. Ky projekt i ka ndryshuar pikëpamjet dhe ka ndërtuar një urë besimi duke i mundësuar OSBE-së dhe komunitetit serb të punojnë së bashku dhe realizojnë këtë projekt, në mënyrë që të përfitojnë shumë njerëz.

"Unë mund të konkludoj," thotë z. Rizova, "se shkolla e pikturës e qetëson situatën shoqëro-politike dhe kjo pranohet prej banorëve, përfaqësuesëve dhe komunitetit vendor dhe Kuvendit Komunal. Kjo është arritja

kryesore e këtij projekti. Arti është një mjet i shkëlqyeshëm për të tejkaluar keqëkuptimet".

Projekti për shkollën e artit figurativ ishte aq i suksesshëm sa një shkollë e ngjashme do të fillojë punën në 'Qendrën e Komunitetit' në Fushë Kosovë. Të rinjtë serbë, romë, shqiptarë dhe ashkali do të ndjekin shkollën së bashku.

"Asgjë në botë nuk i bashkon njerëzit si arti" beson Zorani, dhe zonja Rizova pajtohet. "Suksesi është i kuptueshëm duke marrë parasysh faktin se ky projekt, në mënyrë që të përfitojnë shumë njerëz. "Unë mund të konkludoj," thotë z. Rizova, "se shkolla e pikturës e qetëson situatën shoqëro-politike dhe kjo pranohet prej banorëve, përfaqësuesëve dhe komunitetit vendor dhe Kuvendit Komunal. Kjo është arritja kryesore e këtij projekti. Arti është një mjet i shkëlqyeshëm për të tejkaluar keqëkuptimet".

## Zgjidhet Problemi Shëndetsor në Livoç të Epërm

Përpjekjet e përbashkëta të aktivistëve të fshatit, Kuvendit Komunal dhe Misionit të OSBE-së, rezultuan me ndërtimin e një ambullante në Livoç, financuar nga Fondi për Investime të Vogla për Minoritetet (FIVM)

Nga: Mervlyde Salihu

Fshati Livoç i Epërm gjendet në pjesën perëndimore të Gjilanit. Rreth 3,500 banorë, shqiptarë dhe serb, jetojnë në këtë fshat. Qytetarëve të këtij fshati iu ka munguar përkujdesi mjekësorë për një kohë të gjatë. Por, më në fund, ky problem i rëndë i shëndetësisë u zgjidh.

Kohë më parë, aktivistët e këtij fshati iu drejtuan Kuvendit Komunal të Gjilanit dhe kërkuan ndihmë për ndërtimin e një shtëpie shëndeti në fshatin e tyre. Përkrahja nuk mungoi. Z. Fadil Osmani, drejtor për projekte në Kuvendin Komunal, kontaktoi Zyrën e OSBE-së në Gjilan dhe në bashkëpunim me stafin e saj, filluan punën. Ata bënë një projekt i cili iu dorëzua 'FIVM-it' dhe u aprovua nga bordi i këtij fondi, dhe ndërtimi filloi. Ambullanta tashmë ka përfunduar, është bërë edhe inaugurimi, dhe tani mirëpret pacientët.

Zsh. Lola Ansedë nga Departamenti për Demokratizim i OSBE-së në Gjilan thotë se Misioni i OSBE-së është shumë i kënaqur me këtë projekt. "Ambullanta do t'i shërbejë komunitetit shqiptar

dhe atij serb, dhe tani e tutje do të sigurojë asistencë mjekësore më të mirë," thotë Ansedë. "Kuvendi Komunal ka mbuluar 10% të shpenzimeve, kurse OSBE-ja 90%, nivel i dëshiruar për projektet e 'FIVM-së,'" shtoi ajo. Për më tepër, shefi i ekzekutivit të komunës ka konfirmuar me shkrim se departamenti i shëndetësisë, pronës dhe urbanizimit do të vazhdojnë përkrahjen e tyre duke paguar rrogat e stafit, dhe duke bërë mbikëqyrjen e nevojshme teknike dhe profesionale. Drejtori i departamentit të shëndetësisë dhe mirëqenjes sociale në një letër të veçantë ka konfirmuar se ky departament do të merr përsipër rekrutimin e punëtorëve, do t'iu sigurojë rrogat dhe do të blejë pajisjet mjekësore.

Përveq që ofron shërbime mjekësore, ambullanta do të shtoj numrin e të punësuarve në fshat. Mjekët do të vijnë nga Gjilani, pasi që nuk ka doktor të diplomuar në Livoç, por infermieret do të jenë nga fshati.

Përfaqësuesi i fshatit, Z. Ramadan Kurteshi, tha se ky është një

projekt me rëndësi kapitale për Livoçin. "Kemi qenë një fshat me infrastrukturë tërësisht të pazhvilluar. Tani, me punën e zellshme të aktivistëve të fshatit, Kuvendit Komunal të Gjilanit dhe OSBE-së, jemi shumë fatlum të kemi një shtëpi shëndeti në fshat," tha z. Kurteshi, drejtori i projektit. Sipas z. Osmani, banorët lokal kanë bërë një punë shumë të madhe. "Ata kanë thyer barrierat dhe i kanë tejkaluar ndarjet. Komuniteti shqiptar dhe ai serb janë pajtuar se zgjidhja e problemit të asistencës mjekësore në fshatin e tyre është prioritet."

Puna e fshatarëve u shpague. Halim Ramadani, një i ri nga Livoçi, thotë se është shumë i kënaqur që tani e tutje do të kenë përkudjesje mjekësore në fshatin e tyre. Tani, 3,500 banorët e fshatit Livoç nuk do të kenë nevojë të udhëtojnë deri te qendra më e afërt në Gjilan, e cila nuk është fare afër, për të marrë ndihmë mjekësore. Ky projekt ka treguar se kur njerëzit bien dakord mes vete, zgjidhjet në të mirë të secilit janë të shpejta. Rezultati është mbresëlënës.



Ambullanta në Livoç - para dhe pas



# Përmirësimi e standardit jetësor dhe infrastrukturës

'FIVM-ja' përkrah kthimin, pajtimin dhe minoritarët të mbesin në Kosovë duke përmirësuar kushtet e tyre jetësore.

Nga: Hasan Sopa

Çdo konflikt sjell vuajtje dhe dëme të mëdha në njerëz, e sidomos dëme të mëdha materiale. Konflikti në Kosovë nuk dallonte shumë. Infrastruktura ishte ajo që pësoi më së tepërmi si para ashtu edhe gjatë konfliktit - në veçanti shtëpitë dhe rrugët.

Qëllimi kryesor i Fondit për Investime të Vogla për Minoritetet (FIVM) ishte krijimi i besimit si dhe përmirësimi i gjendjes sociale, shëndetësore e financiare. Një pjesë e mirë e këtij fondi i është dedikuar përmirësimit të infrastrukturës në përgjithësi. Shkolla, klinika shëndetësore, rrjete të ujësjellësit dhe kanalizimi ishin vetëm disa nga projektet me rëndësi vitale të financuara nga 'FIVM'.

Në Kosovë kishte një numër të madh shkollash që kishin nevojë urgjente për rehabilitim. Njëra nga këto ishte edhe shkolla fillore në Vrboc, komuna e Vitisë, kulmi i së cilës ishte në gjendje të

mjerueshme. Projekti kishte për qëllim të përkrah kthimin dhe qëndrimin e komunitetit serb dhe rom të Kosovës, duke përmirësuar kushtet e tyre për arsimim. Përveç komunitetit i cili e përdorte këtë objekt për ngjarje të ndryshme kulturore, përfitues të drejtpërdrejt janë mbi 367 nxënës që vijojnë mësimin në këtë shkollë.

Një shkollë tjetër që ka përfutur nga fondet e 'FIVM'-së është shkolla fillore 'Vuk Karaxhiq' në komunën e Zveçanit. Si njëra ndër institucionet kryesore arsimore në këtë zonë ajo mbleh rreth 792 nxënës. Përveç këtyre janë edhe 225 student të fakultetit të arteve që shfrytëzojnë një pjesë të ndërtesës. Mirëpo, problemi me të cilin është ballafaquar kjo shkollë deri më tash ka qenë sistemi ngrohjes. "Me anë të përmirësimit dhe zëvendësimit të sistemit të ngrohjes në shkollë, projekti kishte për qëllim ngritjen

e standardit arsimor në mënyrë të konsiderueshme. Ky projekt është çmuar shumë lartë nga komuniteti," tha z. Nota Sarafoudi, përgjegjëse e projektit.

Më 26 tetor 2002, pas më tepër se tri vitesh trazirash politike lokale, të raporteve jo të mira ndëretmike dhe institucioneve paralele në komunën e Shtërpçës, shqiptarët dhe serbët e Kosovës dolën për të votuar. Ata zgjodhën Kuvendin Komunal me përfaqësues të komuniteteve përkatëse. "Ky ishte një parakusht i rëndësishëm për themelimin e një forumi zyrtar për një bashkëpunim ndëretmik", shprehet z. Oliver Mekoj përgjegjës i projektit të 'FIVM-së' për komunën e Shtërpçës.

Në ditët e para pas zgjedhjeve, anëtarët e Kuvendit Komunal të Shtërpçës, si përfaqësues të zgjedhur, ishin të shtrënguar t'i kryenin detyrat e tyre në një sallë të papërshtatshme për punë dhe që kishte nevojë për riparime të shumta. Sipas z. Mekoj, renditja jo e duhur e ulseve në sallë i përngjante më tepër një klase nxënësish. "Sigurisht se kjo nuk ishte e përshtatshme as për udhëheqjen e një dialogu ndëretmik apo për diskutime të hapura të problemeve komunale. Prandaj u inicua një projekt për riparimin e objektit, rivendosjen e ulseve dhe që përfundimisht të mbështesë kuadrin e Kuvendit Komunal të Shtërpçës," shton z. Mekoj.

Kur e pyetëm z. Mekoj se si duket tani sallja e Kuvendit Komunal, ai duke qeshur tha, "tani është krejt ndryshe, e rimodeluar dhe e paj-



Sistemi i ri i ujësjellës në Koloninë e Vjetër

sur sipas standardeve të pranueshme".

Novobërda është ndër komunat më të vogla të Kosovës me më pak se 3.000 banorë shqiptarë, serb dhe romë. Pjesa dërrmuese e popullatës siguron egzistencën e vet kryesisht nga bujqësia. Papunësia është e lartë dhe ka shumë pak perspektivë punësimi. Infrastruktura në këtë komunë, si edhe në shumicën e komunave të Kosovës, është e dobët.

Në fillim të këtij viti administrata lokale dhe UNMIK-ku filluan të kërkojnë fonde për përmirësimin e infrastrukturës dhe kështu shumë shpejt i bashkuan forcat me 'FIVM-në'. Njëri nga projektet ishte ndërtimi i sistemit të kanalizimit, kurse një tjetër kishte të bënte me ndërtimin e sistemit të ri të ujësjellësit. Të dyja këto projekte ishin të një rëndësie të veçantë për përmirësimin e standardit jetësor në radhë të parë, dhe për qëndrimin e

banorëve në Koloninë e Vjetër.

Sipas përgjegjës të projektit z. Ljubisha Simiq, "qëllimi i projektit ka qenë që banorëve të fshatit tu ofrohet një sistem i duhur kanalizimi dhe ujë të pijshëm. Poashtu projekti ka ndikuar në përmirësimin e kushteve jetësore për të gjithë banorët e këtij vendbanimi të pëzier," konkludon z. Simiq.

Z. Blagoje Steviq, një i kthyer në Koloninë e Vjetër thotë: "Ne vërtetë jemi të lumtur që na i mundësuan këto dy sisteme. Kjo e bën jetën tonë më të lehtë dhe më të mirë. Edhe punët janë kryer shumë mirë."

Më së 407,739 Euro, nga shumata e përgjithshme e buxhetit të 'FIVM-it' u janë dedikuar 14 projekteve të ndryshme në infrastrukturë. Në shumë raste, këto projekte kanë ndikuar pozitivisht në përmirësimin e standardit jetësor të komuniteteve.

Çatia e re e shkollës në Vrboc



## Integrimi përmes Teknologjisë Informative

Ndërtimi i shoqërisë civile dhe mbështetja e komuniteteve të ndryshme etnike që jetojnë në rajonin e Pejës është prioriteti i OSBE/'FIVM'

Nga: Hysen Pelaj

Komuniteti egjiptian në Pejë ballafaqohet me vështirësi të shumta kur bëhet fjalë për shkollimin e fëmijëve të tyre. Kjo ndodhë ngase është vështirë për rininë egjiptase në Kosovë të tejkaloj nivelin e ultë të shkollimit, dhe të integrohet në mënyrë profesionale në shoqërinë kosovare. Duke pasur parasysh këtë fakt, OJQ-ja vendore 'Piramida-Dituria' (OJQ egjiptiane) në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin për Demokratizimin pranë OSBE-së, hartuan dhe dorëzuan projekt propozimin pranë 'Bordit Këshilldhënës i FIVM-it', i cili u aprovua në qershor të vitit 2002.

Projekti përqëndrohej në pajtimin e komuniteteve si dhe integrimin afatgjatë të rrjetit të rinisë egjiptase 'Piramida-Dituria' në rrjetin e rinisë multietnike në Pejë, si dhe në komunitetet tjera. Tri komponentet kryesore të pro-

jektit janë: stacionet e internetit, teknologjia informative (TI) dhe kurset e gjuhës angleze. Pjesë thelbësore e çdo komponente ishte zhvillimi i komunitetit dhe rrjetit rinorë.

Qendra e Rinisë "Haxhi Zeka" për gjashtë muaj me rradhë duket si një zgjidhje e blutësh me 60 të rinj të komunitetit egjiptas nga Peja dhe Istogu, të cilët ndiqnin kurset nga gjuha angleze dhe për kompjuter. Të rinjtë egjiptas për herë të parë prisnin para kompjuterit që të fillonin mësimin e programeve elementare. Shumë vajza duhej të tejkalonin paragjykimet e ashpra në lidhje me shkollimin e vajzave në komunitetet e tyre rurale, në mënyrë që t'i ndiqnin kurset. Ky ishte një rast i rëndësishëm posaçërisht për to. Ndjenjë e njetë ishte prezente edhe në kursin e gjuhës angleze, ku fëmijët garonin në mes veti në mësimin e më shumë fjalëve, shprehjeve

dhe dialogjeve të tëra në gjuhën angleze. Në shumicën e rasteve vajzat e vendosura të shfrytëzojnë maksimumin e mundësive për të mësuar, tregoheshin më të shkathëta se djemtë.

Të vendosur në zyrën e OJQ-ës

lokale 'Piramida-Dituria', qendra u ka mundësuar egjiptasve të rinj, si dhe të rinjëve nga komunitet shqiptarë, boshnjake dhe rome, t'i shfrytëzojnë shërbimet në internet pa pagesë. Në të vërtetë, koordinatori i OJQ-ës



Të rinjtë të bashkësive të ndryshme gjatë trajnimeve të teknologjisë informative

ka mbajtur trajnime të përziera se "si të përdoret interneti". Të rinjtë e komuniteteve të ndryshme me nivele të ndryshme shkollimi, kalonin të shumtën e kohës duke mësuar së bashku, duke u konsultuar ose duke huaruar libra nga biblioteka, tanimë e pajisur mirë. Biblioteka është furnizuar me botimet e fundit të librave në të tri gjuhët (shqipe, serbe dhe angleze) në fushën e teknologjisë informative (më e mira në qytet) dhe të gjuhës angleze (librat e kurseve dhe gramatikës, enciklopedi e të tjera).

Përkrahja e egjiptasve të Kosovës dhe komuniteteve tjera është mënyra më e mirë për të inkurajuar riintegrimin, gjë që është vitale për një të ardhme më të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Pas një periudhe të shkurtër kohore, ky projekt i të rinjëve u tregua mjaft efikas.

# Nxitje për tu integruar dhe vijuar shkollën

Vizitime të shpërndara, ngjyra dhe lodra, gjuhë të ndryshme dhe fytyra të gëzuara mbushin dhomën. Ky është kopshti për fëmijët romë në Gjilan.

Nga: Mervlyde Salihu

Pikërisht në këtë ambient Brenda Demiri, tani 7 vjeçare dhe nxënëse e klasës së dytë të shkollës fillore, është kënaqur duke lozur dhe mësuar. Për dy vite me radhë në kopsht, ajo ka mësuar këngë, valle, kulturë dhe gjuhën shqipe duke u përgaditur për shkollën fillore.

Kopshti për fëmijët romë të Kosovës është hapur si pjesë e punës së përbashkët së OSBE-së, UNICEF-it, "Balkan Sunflowers" dhe Organizatave tjera lokale dhe ndërkombëtare. Projekti synon përmirësimin e jetës së komunitetit romë dhe inkurajon ata të qëndrojnë në komunë. Kopshti synon të përgadis fëmijët romë për pranim dhe riintegrim të suksesshëm në shkolla fillore ku vijojnë mësimin fëmijë nga komunitete të ndryshme. Në këtë mënyrë, ata mësojnë gjuhën shqipe dhe aftësohen në çështje edukative dhe shoqërore. Kjo besohet të jetë me rëndësi në inkurajimin e komunitetit të qëndrojë aty ku është.

"Në fillim kopshti është paguar

nga Buxheti për Minoritete i Departamentit për Demokracizim, por në vitin 2002 projekti i është propozuar Fondit për Investime të Vogla për Minoritete (FIVM) dhe është miratuar, kështu që FIVM-i e ka financuar gjatë gjithë vitit 2002," tha Lola Ansedo, menaxhere e projektit pranë OSBE-së.

Përafërsisht 25 fëmijë kanë vijuar kopshtin në vitin 2002. Në shtator, të gjithë fëmijët që kanë mbushur gjashtë vjet kanë filluar të ndjekin mësimin fillor. Në të vërtetë, z. Ansedo beson se "numri i fëmijëve do të rritet sepse ne po inkurajomë më shumë fëmijë nga familjet e varfëra ose familjet me nevoja të veçanta të si dhe fëmijët prindërit e të cilëve kanë probleme mentale."

"Mësimi dhe argëtimi së bashku duket t'i inkurajojë fëmijët si Brenda Demiri të shkojnë së pari në kopsht e pastaj edhe në shkollë. "Mendoj se ata me të vërtetë kënaqen këtu sepse kalojnë kohë së bashku. Nëse nuk

do të vinin këtu, do të luain në rrugë. Këtu ata luajn dhe mësojnë," thotë Brenda Gallagher, nga organizata 'Balkan Sunflowers'. Z. Ansedo shton, "fëmijët këtu mësojnë sjelljet elementare në shoqëri, janë shumë të pastër dhe mësojnë se si të sillen. Ata gjithashtu mësojnë gjuhën shqipe dhe ngapak atë angleze, si dhe të vizitojnë dhe këndojnë."

Kopshti ndihmon në zvogëlimin e problemeve që kanë të bëjnë me numrin e vogël të shkollimit të gjeneratave të reja të romëve në Gjilan. Duke inkurajuar shkollimin fillor, forcohet dhe inkurajohet procesi i rinteprimit dhe pajtimit afatgjatë.

Brenda tani ka kaluar moshën për të shkuar në kopsht, por në mesin e fëmijëve tjerë prezent, ne e gjetëm motrën e saj, Berkanën, një vajzë simpatike 5 vjeçare me sy të zinj, duke vizituar dhe duke u kënaqur.

Suksesi i këtij projekti të FIVM-it pritet të vazhdojë në të

ardhmën pasi që z. Lutfi Haziri, kryetar i komunës së Gjilanit, ka nënshkruar një letër në shkurt të vitit 2003, ku thekson se komuna do të merr përsipër financimin e kopshtit nga janari i vitit 2004. Kjo e bën kopshtin institucion zyrtar, institucion të komunës.

"Shpresojmë që kopshti do të ekzistojë përgjithmonë dhe do të përkrahet nga komuna në mënyrë që të vazhdojë tu ndihmojë fëmijëve romë të integrohen në shkolla fillore dhe me nxënës nga komunitete të ndryshme," shtoi z. Ansedo.



Fëmijët romë duke u argëtuar në kopshti e fëmijëve

## Si jeton ana tjetër

"Garantimi i shprehjes së lirë është jetike për kosovarët e rinj," thotë Eva Sitkovska, zyrtare e Demokracizimit për minoritete pranë zyrës së OSBE-së në Mitrovicë.

Nga: Hysen Pelaj dhe Slavica Staletoviq

Liria e të shprehurit është e rëndësishme për tu arritur pajtimi dhe kuptimi në mes të komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Dy projekte të Fondit për Investime të Vogla për Minoritete (FIVM), për botimin e revistave për të rinj kanë bërë një përparim të mirë në këtë sferë. Projekti i parë në Mitrovicë rezultoi me botimin dhe shpërndarjen e dy revistave, 'Vitet e Çapënerisë' dhe 'Ardhmëria'. Ekipi i dytë në rajonin e Pejës botoi revistën për të rinj me titull 'Rrethi' Dushan Radakoviq, një gazetar serb i Kosovës për revistën 'Ardhmëria' na tha, "mendoj se

ky projekt është jetik në përafërimin e serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës në mënyrë që të punojnë pa pengesa në Mitrovicë."

Që të dy projektet e FIVM-së për botimin e revistave për të rinj kanë pasë për qëllim dhe ia kanë dalur që t'i bashkojnë të rinjtë të shprehën, të ndërtojnë miqësi dhe të tregojnë se si jetojnë ata. Në të njëjtën kohë, të rinjtë kanë përfutur duke marrë njohuri të reja në gazetari dhe kompjuterë përmes trajnimeve, seminareve, mbledhjeve dhe përvojës së punës.

Në Mitrovicë, ekipi i revistës 'Ardhmëria' i përbërë nga serbë

dhe shqiptarë kosovarë tregoi një kurajo të madhe gjatë kalimit të urës me qëllim që të marrin pjesë bashkarisht në mbledhjet javore dhe mujore redaktuese në Qendrën e Kulturës. Këto mbledhje u dhanë mundësi 17 pjesëmarrësve të komuniteteve të ndryshme të flasin lirshëm për situatën dhe problemet në Mitrovicë, si dhe të ofrojnë të dhëna se si jetojnë të dyja palët.

Kalimi i pengesave me qëllim të lejimit të një gazetarie të lirë dhe të vërtetë ishte një sfidë me të cilën u përballën të gjithë pjesëmarrësit e 'Ardhmërisë'.

Megjithatë, koncentrimi në fusha me interes të përbashkët për çdo djalë apo vajzë, siç janë moda dhe filmi, ia dolën që ta kapërcëjnë këtë çështje. Miranda Hochberg, kryekordinatore në 'Qendrën për Paqe për Fëmijë dhe të Rinj' (QPFR), shpjegon se forujt javore të rinisë kanë luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm në Mitrovicë. "Trajnuesi do të mund të drejtoj diskutime grupore me temat siç janë gjinia apo tema tjera relevante. Forumi do t'i zhvilloj intervista dhe ato do të transmetohen përmes radiostacioneve në jug të Mitrovicës si dhe përmes 12 radio stacioneve tjera në Kosovë."

"Unë ende shkruaj për revistën

'Ardhmëria', thotë Edona Zhuri, një gazetare e re dhe shton se 'Ardhmëria' u pavarësua pas numrit të parë dhe ajo ende vazhdon të punojë me sukses. Shkrimi për 'Ardhmërinë' më jep kënaqësi të madhe. Këtu i kam bërë hapat e parë të gazetarisë, mirëpo ende vazhdoj të mësoj. Në të vërtetë, e gjithë ajo që kam mësuar gjatë vitit të kaluar më shtyn të vazhdoj punën në gazetari."

Në Gorazhdëc dhe Osojan, komuna e Pejës, shumica e anëtarëve të revistës 'Rrethi' jetojnë në kushte të këqija në enklava, ku liria e lëvizjes është problem. Revista 'Rrethi' u ka mundësuar këtyre fëmijëve të mblidhen së bashku për herë të parë. Revista ofron një mundësi për të rinjtë serb kosovarë të ngrisin çështjet që i brengosin ata dhe të shkëmbejnë ide që kanë të bëjnë me komunitetin e tyre," na tha një zyrtar i projektit.

Botimi i gjashtë numrave të revistës 'Rrethi' ka përmirësuar aftësitë hartuese të anëtarëve përmes trajnimeve dhe seminareve të organizuara nga OSBE-ja dhe organizata tjera ndërkombëtare. Me të rinjtë kanë punuar edhe tre kordinatorë që u kanë ndihmuar të shkruajnë artikujt për sport, edukim, fe dhe çështje shoqërore e të infrastrukturës.

"Ishte me të vërtetë ndjenjë e mirë kur njerëzit pyesnin se kur do të nxjerrim numrin tjetër të Rrethit," na tha njëri nga anëtarët. Për shumë njerëz, Rrethi është burim i vetëm në dispozicion nga i cili mund të informohen për ngjarjet dhe jetën në fshatra. Rrethi përmes

aktivitete tjera ka ndihmuar në tejkalimin e pengesave ekzistuese në mes të rinjëve të komuniteteve të përziera, duke hequr paragjykimet dhe klishetë e fuqishme që ekzistojnë në parë. Shumë miqësi janë lidhur si rezultat i kësaj.

Znj. Hochberg na spjegoi se çka kanë arritur anëtarët e revistës Ardhmëria, "sot, nëntë nga këta shtatëmbëdhjetë anëtarë ende punojnë në QPFR, kurse tetë të tjerë punojnë për radio dhe televizione profesionale, siç janë TV Most (Ura) dhe RTK. Pra, ata kanë mësuar diçka dhe me të vërtetë janë duke i zbatuar njohuritë që i kanë marrë. Nëse nuk kanë punë si gazetarë, ata studiojnë gazetarinë."

"Unë kam mësuar mjaft për gazetarinë dhe revista Ardhmëria ka qenë pikënisja ime për tu bërë gazetar. Tash punoj për RTK-në dhe shpresoj se bashkësia ndërkombëtare do të vazhdojë ta finansojë këtë projekt unik të serbëve dhe shqiptarëve kosovarë," thotë Dushan Radakoviq.

Plani i revistës Ardhmëria është që të bëjë një revistë më të vogël në të dy gjuhët. Anëtarët e rinj duan që të shohin se çfarë do të jenë reagimet ndaj botimit të një reviste në të dy gjuhët. Ndoshta edhe ne do të mësojmë diçka nga e tërë kjo.

Nuk ka dyshim se të dy projektet e revistave u kanë ndihmuar anëtarët e rinj të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të mësojnë më tepër se si jeton pala tjetër. Ata kanë mësuar edhe për atë se si të jetohej së bashku në Kosovë



Shtypja i buletinit informativ